

VENDIM
Nr. 46, datë 18.9.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Illir Toska	anëtar,
Marjana Semini	anëtare;
Genti Ibrahimi	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datat 4.3.2025, 1.7.2025 dhe 18.9.2025, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 14 (D) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Drita Pulleja, Gani Qatipi, Luljeta Qatipi, Gazmir Qatipi, Dorina Qatipi, Florian Qatipi

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Afërdita Shkreli, Mehmet Shkreli, Refat Shkreli, Gëzim Xhemrishi, Ylli Xhemrishi, Mimoza Xhemrishi, Adrian Xhemrishi, Luljeta Hysa, Petrit Hysa, Avdi Hysa, Sokol Hysa, Kreshnik Hysa, Ornella Qatipi, Hajredin Qatipi.

Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Këshilli i Qarkut Tiranë, në mungesë.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2, përfaqësuar nga juristi Arjan Halilaj, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-698, datë 17.1.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 18, 33, 41, pikat 1 dhe 2, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuësve, (*kërkuesit*), të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Afërdita Shkreli, Mehmet Shkreli, Refat Shkreli dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (*ASHK*), Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Këshilli i Qarkut Tiranë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Komisioni i Ndarjes së Tokës (*KNT*) i fshatit Mëzez, Tiranë, bazuar në ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën” (*ligji nr.7501/1991*), me aktin nr. 75, datë 15.10.1993, i ka dhënë në

përdorim shtetasit Nj. Sh. në cilësinë e punonjësit të Ndërmarrjes Bujqësore, 5.000 m², vresht, në ngastrën kadastrale nr. 8, me kufizimet përkatëse. Po ky komision, me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) nr. s'ka, datë 15.10.1993, të njëjtën sipërfaqe toke ia ka dhënë në pronësi po këtij shtetasi, i cili e ka regjistruar më pas në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), Tiranë, në datën 8.9.1998. Në vijim, me shkresën nr. 488/1, të datës 4.5.1995, Seksioni i Kadastrës ka njoftuar shtetasin Nj. Sh. se AMTP-të e datës 15.10.1993, janë të pavlefshme, pasi ai nuk ka rezultuar banor i fshatit Mëzez, por i qytetit të Tiranës. Ky njoftim nuk rezulton të jetë kundërshtuar në Komisionin Qeveritar të Tokës (KQT), si organi më i lartë administrativ, ose në rrugë gjyqësore.

2. Kërkuesit (pala e paditur në procesin gjyqësor të përmbyllur me vendimin e kundërshtuar) janë trashëgimtarë ligjorë të shtetasit Y. A., të cilit, në bazë të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve" (ligji nr.7698/1993), me vendimin nr. 220, datë 22.6.1995, (vendimi nr. 220/1995) të ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë (ish-KKKP-ja, Tiranë), i është njohur dhe kthyer sipërfaqja 9.000 m² truall në fshatin Mëzez, komuna Kashar, Tiranë, me kufizimet përkatëse, pasuri që është regjistruar më pas në ZRPP-në, Tiranë.

3. Në vijim, me vendimin nr. 5, datë 13.7.1999, Komisioni i Tokës i Këshillit të Rrethit Tiranë ka anuluar aktin e marrjes së tokës në pronësi, lëshuar në emër të shtetasit Nj. Sh. (trashëgimlënësi i paditësve të kundërpaditur) nga KNT-ja, Mëzez, për sipërfaqen 5.000 m², si të dhënë në kundërshtim me ligjin nr. 7501/1991. Në vijim, ZRPP-ja, Tiranë ka deklaruar të pavlefshëm regjistrimin e bërë nga shtetasi Nj. Sh. dhe certifikatën e pronësisë të datës 8.9.1998 të lëshuar në emër të tij, si dhe ka bërë regjistrimin e tokës në emër të kërkuesve. Ndërsa me shkresën e datës 13.7.2000 kryetari i komunës Mëzez, në cilësinë edhe të kryetarit të KNT-së, ka vlerësuar se sipas VKM-së nr. 230, datë 22.7.1991, "Për krijimin e komisioneve të tokave", Komisioni i Tokës së Këshillit të Rrethit Tiranë nuk ka të drejtë të shfuqizojë dokumentacionin e tokës.

4. Në datën 6.6.1996, shtetasi Nj. Sh. ka paditur në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë kërkuesit (trashëgimtarë të shtetasit Y.A.) dhe ish-Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Tiranë (ish-AKKP-ja), me objekt kundërshtimin pjesërisht të vendimit nr. 220/1995 të KKKP-së, Tiranë, për sipërfaqen 5.000 m², me pretendimin se ajo mbivendoset me sipërfaqen e tokës së fituar prej tij sipas ligjit nr. 7501/1991, duke kërkuar edhe çregjistrimin e kësaj sipërfaqeje nga pronësia e kërkuesve dhe regjistrimin në emrin e tij. Kërkuesit kanë paraqitur kundërpadi, duke kërkuar lirim dhe dorëzimin e sipërfaqes 5.000 m², me pretendimin se e kanë fituar pronësinë në bazë të ligjit nr. 7698/1993 dhe se kjo pronë mbahet në mënyrë të paligjshme nga ana e paditësit.

5. Me vendimin nr. 8281, datë 11.10.1996, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e padisë dhe rrëzimin e kundërpadisë, duke anuluar pjesërisht vendimin nr. 220/1995 të KKKP-së, Tiranë, si të pabazuar në ligj dhe në prova. Për ankimin e kërkuesve, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 13, datë 8.1.1997, ka vendosur mospranimin e tij. Mbi bazën e rekursit të kërkuesve, me vendimin nr. 1615, datë 13.11.1997, Gjykata e Kasacionit ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim po në atë gjykatë. Në rigjykim, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1283, datë 23.9.1998, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 8281, datë 11.10.1996, të gjykatës së shkallës së parë. Ndërsa Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 966, datë 21.10.1999, ka vendosur prishjen e vendimeve të gjykatave të faktit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë, duke lënë si detyra për këtë gjykatë: i. vlerësimin e ligjshmërisë ose paligjshmërisë së AMTP-ve; si dhe ii. thirrjen në gjykim si persona të interesuar të komisioneve përkatëse të ndarjes së tokës, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes sipas ligjit.

6. Në rigjykimin e çështjes, me vendimin nr. 5311/1068, datë 1.2.2000, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes. Ky vendim është prishur me vendimin nr. 811, datë 12.9.2000, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe çështja është dërguar për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Kjo e fundit, në rigjykim, me vendimin nr. 3124, datë 12.7.2002, ka

vendosur pranimin e padisë, anulimin pjesërisht të vendimit nr. 220/1995 të KKKP-së, Tiranë, urdhërimin e fshirjes së regjistrimit në emër të kërkuësve dhe regjistrimin në emër të trashëgimtarëve të shtetasit Nj. Sh., si dhe rrëzimin e kundërpadisë. Gjatë gjykimit gjykata ka proceduar me zëvendësimin procedural të paditësit Nj. Sh. me trashëgimlënësit e tij, si dhe ka thirrur si persona të tretë ish-ZRPP-në, Tiranë dhe KNT-në, Kashar. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 503, datë 17.4.2003. Mbi bazën e rekursit të kërkuësve, me vendimin nr. 1118, datë 1.6.2004, Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim po në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Sipas Gjykatës së Lartë, gjykatat më të ulëta nuk kanë vlerësuar ligjshmërinë e akteve të komisionit të tokës, të cilat paraqesin kontradikta në përmbajtjen e tyre, si dhe vendimin e KKKP-së, Tiranë nuk kanë zbatuar detyrat e lëna prej saj me vendimin nr. 966, datë 21.10.1999, të detyrueshme për gjykatën që rigjykon çështjen, bazuar në nenin 486 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Po kështu, ajo ka vlerësuar se vendimi i gjykatës së apelit ka mungesë të analizës së provave dhe të bazës ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes.

7. Në zbatim të detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 32, datë 22.1.2007, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, rrëzimin e padisë dhe pranimin e kundërpadisë të paraqitur nga të paditurit (kërkuësit), duke detyruar paditësit t'u lirojnë e dorëzojnë të paditurve kundërpaditës sipërfaqen 5.000 m². Ky vendim është prishur me vendimin nr. 406, datë 19.6.2014, të Gjykatës së Lartë, e cila e ka dërguar çështjen për rigjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, me tjetër trup gjykues. Sipas Gjykatës së Lartë, në rishqyrtimin e çështjes gjykata e apelit duhet të kryente një hetim të plotë e të gjithanshëm.

8. Pas rigjykimit të çështjes, përfundimisht, me vendimin nr. 2315, datë 18.11.2015, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 3124, datë 12.7.2002, të gjykatës së shkallës së parë, por me ndryshimin që kërkuësit të kompensohen për sipërfaqen prej 5.000 m² në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji. Kundër vendimit të gjykatës së apelit kanë ushtruar rekurs kërkuësit dhe Agjencia e Trajtimit të Pronës, të cilët kanë kërkuar rrëzimin e vendimit dhe pranimin e kundërpadisë, duke parashtruar, ndër të tjera, si shkaqe kryesore: pavlefshmërinë absolute të AMTP-së, datë 15.10.1993, nxjerrë nga KNT-ja e komunës Mëzez, në kapërcim të kompetencave që i njihte ligji; paditësi Nj. Sh. është vërtetuar që ishte banor i qytetit të Tiranës dhe njëkohësisht anëtar i Ndërmarrjes Bujqësore, pra duke mos përmbushur kriteret e përcaktuara në nenin 6, të ligjit nr. 7501/1991 për të marrë AMTP-në; AMTP-ja në emër të shtetasit Nj. Sh. është shfuqizuar nga KNT-ja e Këshillit të Rrethit Tiranë me vendimin nr. 5, datë 13.7.1999, i cili nuk rezulton të jetë kundërshtuar nga pala paditëse; nga akti i ekspertimit nuk rezulton mbivendosje pronash, fakt i konfirmuar nga ekspertja në seancë gjyqësore; sipërfaqja 5.000 m² ka qenë e lirë në kuptim të ligjit.

9. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2024-698, datë 17.1.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 472 të KPC-së. Sipas asaj gjykate, janë respektuar normat procedurale dhe janë zbatuar drejt dispozitat e ligjit material, duke bërë një cilësim të drejtë të fakteve dhe rrethanave që lidhen me mosmarrëveshjen. Po kështu, shkaqet e parashtruara në rekurs ngrenë kryesisht çështje të vlerësimit të provave dhe të fakteve, të cilat dalin jashtë juridiksionit rishikues dhe ligjor të saj.

10. Në datën 22.7.2024, kërkuësit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Në datën 28.10.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Pas konstatimit të mungesës së njoftimit për disa nga subjektet e interesuara, konkretisht të shtetasve Rahmije Xhemrishi, Arife Hysa, Ornela Qatipi dhe Hajredin Qatipi, Gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës, me qëllim njoftimin e tyre. Po kështu, nga aktet shkresore të administruara, Gjykata konstatoi se kërkuësi Izeir Qatipi dhe subjektet e interesuara Rahmije Xhemrishi, Arife Hysa dhe Nanie Shkreli kanë ndërruar jetë. Në këto kushte, Gjykata e ka vlerësuar të nevojshëm kërkimin e dokumentacionit ligjor për trashëgimtarët e tyre. Në vijim, me vendimin e datës 10.6.2025, për

kalimin procedural të palëve në proces, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur thirrjen në cilësinë e kërkuësve të shtetasve Luljeta Qatipi, Gazmir Qatipi dhe Dorina Qatipi, si dhe në cilësinë e subjekteve të interesuara të shtetaseve Gëzim Xhemrishi, Ylli Xhemrishi, Mimoza Xhemrishi, Adrian Xhemrishi, Luljeta Hysa, Petrit Hysa, Avdi Hysa, Sokol Hysa dhe Kreshnik Hysa. Në seancën e datës 1.7.2025, Gjykata, pasi konstatoi se subjektet e interesuara në këtë çështje Refat Shkreli, Mehmet Shkreli, Luljeta Hysa, Avdi Hysa, Petrit Hysa, Kreshnik Hysa, Sokol Hysa, Adrian Xhemrishi, Gëzim Xhemrishi, Ylli Xhemrishi, Mimoza Xhemrishi, Hajredin Qatipi nuk kishin marrë dijeni për gjykimin kushtetues të çështjes, ka vendosur shtyrjen e seancës plenare, me qëllim njoftimin e tyre me shpallje dhe caktimin e seancës plenare të radhës në datën 18.9.2025.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se vendimi i kundërshtuar u ka cenuar *të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

11.1 *Parimit të sigurisë juridike dhe të pritshmërive të ligjshme*, pasi në kuptim të jurisprndencës kushtetuese dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), vendimi i KKKP-së, Tiranë, mbi bazën e të cilit ka fituar pasurinë trashëgimlënësi i kërkuësve, krijon të njëjtën pritshmëri si një vendim gjyqësor që njeh pronësinë mbi sendin. Për sa kohë që pasuria në pronësi të tyre është fituar me vendim të ish-KKKP-së, ai barazohet me vendim gjyqësor dhe ka krijuar pritshmëri të ligjshme tek ata që do të vihen në posedim të pronës ose do të dëmshpërblehen për të.

11.2 *Parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, pasi Gjykata e Lartë duhet ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore dhe në prani të palëve ndërgjyqëse, të cilat duhet t'i kishte njoftuar për orën dhe datën e gjykimit, ndërkohë që gjykimi i saj në dhomën e këshillimit u ka mohuar të drejtën për të marrë pjesë në gjykim dhe për të paraqitur prova e argumente në mbrojtje të interesave të tyre. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk ka kryer zëvendësimin procedural të palëve që kishin ndërruar jetë, duke u cenuar edhe të drejtën për *shqyrtim efektiv e në mënyrë të pavarur të rekursit*.

12. **Subjektet e interesuara**, Afërdita Shkreli, Mehmet Shkreli, Refat Shkreli, në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar si vijon:

12.1 Pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike dhe të pritshmërive të ligjshme* është i pabazuar, pasi ata e kanë fituar të parët titullin e pronësisë dhe janë ata që janë cenuar në të drejtën e pronës, për të cilën ligji duhet t'u ofronte siguri, qartësi dhe vazhdimësi të kësaj të drejte. Pritshmëritë e kërkuësve për kthimin dhe kompensimin e pronës nuk janë mohuar, pasi gjykatat kanë vendosur kompensim për sipërfaqen e pronës së mbivendosur, duke dhënë arsyet për vlerësimet e tyre.

12.2 Pretendimet për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, si dhe *së drejtës për shqyrtim efektiv të rekursit*, në mënyrë të pavarur, janë të pabazuara, pasi gjykimi i çështjes në dhomën e këshillimit nga Gjykata e Lartë është bërë në përputhje me parashikimet e nenit 480 të KPC-së. Pavarësisht kohës së regjistrimit të rekursit, për sa i takon formimit të trupit gjykues, procedurës së gjykimit dhe mënyrës sesi disponon, Gjykata e Lartë u referohet dispozitave ligjore në fuqi. Lidhur me zëvendësimin procedural të palëve që kanë ndërruar jetë, nuk është arritur të provohet cenimi në të drejtat kushtetuese të kërkuësve, pasi me këtë pretendim synohet mbrojtja e të drejtave të personave të tjerë në procesin gjyqësor. Po kështu, gjykata e apelit ka respektuar ligjin procedural dhe palët kanë pasur mundësi të realizojnë të drejtën e mbrojtjes, të paraqesin prova, të njihen me provat e palës kundërshtare, të debatojnë e të shprehin qëndrimet e tyre, duke respektuar parimet bazë të procesit të rregullt ligjor.

13. **Subjekti i interesuar, ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar të njëjtat pretendime me subjektet e interesuara Afërdita Shkreli, Mehmet Shkreli dhe Refat Shkreli, duke shtuar se në datën 7.4.2016, pas regjistrimit të vendimit nr. 2315, datë 18.11.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë, ZRPP-ja (sot ASHK-ja) ka kryer certifikimin e pronës me sipërfaqe 5.000 m², lloji i pasurisë “arë”, duke pajisur trashëgimtarët e shtetasit Nj. Sh. me certifikatën e pronësisë.

14. **Subjekti i interesuar, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Këshilli i Qarkut Tiranë**, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesve

15. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a, të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

16. Lidhur me legjitimitimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individit duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i përket aspektit substancial, Gjykata ka theksuar se individit, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të tregojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se në ankimin kushtetues individual kërkuessit kanë pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka kryer zëvendësimin procedural të palëve të paditura në procesin gjyqësor objekt ankimi që kishin ndërruar jetë. Ndërsa subjektet e interesuara kanë prapësuar se kërkuessit nuk kanë arritur të provojnë cenimin në të drejtat e tyre kushtetuese si rrjedhojë e moskryerjes së zëvendësimit procedural të palëve që kishin ndërruar jetë, pasi me këtë pretendim synohet mbrojtja e të drejtave të personave të tjerë në procesin gjyqësor. Për sa i takon këtij pretendimi, duke mbajtur parasysh edhe faktin se vendimi i kontestuar i Gjykatës së Lartë është vendim mospranimi, i marrë në ushtrim e sipër të veprimtarisë seleksionuese të kësaj të fundit, pa vlerësuar në themel pretendimet e kërkuessve, Gjykata çmon se kërkuessit, si subjekte të kushtëzuara, nuk legjitimohen *ratione personae* në aspektin substancial, pasi nuk kanë arritur të provojnë cenimin e të drejtave të tyre kushtetuese për këtë shkak. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të tjera, Gjykata çmon se kërkuessit legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi janë palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e paraqitur.

18. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuessit i janë drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

19. Kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 17.1.2024 dhe sipas informacionit të kësaj gjykate, të vënë në dispozicion të Gjykatës nga përfaqësuesit ligjorë të tyre, ai është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 20.3.2024, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 22.7.2024 (dita e fundit e afatit ka qenë ditë pushimi, e shtunë), pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës.

20. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, në ankimin kushtetues individual kërkuesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit në aspekt të së drejtës për shqyrtim efektiv e në mënyrë të pavarur të rekursit, si dhe parimit të sigurisë juridike në aspekt të pritshmërive të ligjshme, pretendime të cilat bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

21. Për sa u takon pretendimeve për cenimin e parimit të barazisë së armëve në procesin gjyqësor dhe të kontradiktoritetit në drejtim të së drejtës për shqyrtim efektiv e në mënyrë të pavarur të rekursit, kërkuesit kanë parashtruar si argument se çështja është gjykuar nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit pa dijeninë e tyre dhe pa i njoftuar për datën e orën e zhvillimit të seancës, në cenim të së drejtës së tyre për të marrë pjesë në gjykim, për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë.

22. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se çështja është gjykuar nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, në përputhje me parashikimet e nenit 480 të KPC-së. Sipas tyre, pavarësisht kohës së regjistrimit të rekursit, për sa i takon formimit të trupit gjykues, procedurës së gjyqimit dhe mënyrës se si disponon, Gjykata e Lartë u referohet dispozitave ligjore në fuqi. Po kështu, gjykata e apelit ka respektuar ligjin procedural dhe palët kanë pasur mundësi të realizojnë të drejtën e mbrojtjes, të paraqesin prova, të njihen me provat e palës kundërshtare, të debatojnë e të shprehin qëndrimet e tyre duke respektuar parimet bazë të procesit të rregullt ligjor.

23. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit në Gjykatën e Lartë është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Sipas këtyre standardeve, kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraparak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 26, datë 27.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Më tej, në rastin kur rekursi plotëson kushtet e pranueshmërisë, çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore, si rregull, në dhomën e këshillimit mbi bazë dokumentesh (*neni 482 i KPC-së*) ose në prani të palëve (*neni 482/a i KPC-së*), shqyrtim për të cilin palët njoftohen për ditën, orën dhe përbërjen e trupit gjykues, të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, përmes shpalljes në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjyqimit (*neni 482/a, pika 2, i KPC-së*).

24. Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se e drejta për t’u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshme të individit. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi, për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjake, në raport me palën kundërshtare. Ajo u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 6, datë 27.1.2017; nr. 34, datë 25.7.2011; nr. 34, datë 3.10.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje me rekursin e kërkuesve. Nga aktet bashkëlidhur ankimit kushtetues, në rekurs nuk rezulton që kërkuesit apo përfaqësuesi i tyre ligjor të kenë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit, me qëllim njoftimin

e tyre për datën dhe orën e gjykimit, sipas parashikimeve të nenit 482, pika 3, të KPC-së dhe urdhrit nr. 131, datë 2.7.2021, “Për publikimin e datave të gjykimeve dhe njoftimin e palëve”. Ndërsa, nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë, rezulton se në datën 27.12.2023, në rubrikën “Çështje të shpallura për gjykim”, kategoria “Çështje civile”, nënrubrika “Për shqyrtim në dhomë këshillimi”, është shpallur lista e çështjeve për shqyrtim në datën 17.1.2024, ora e seancës, si dhe përbërja e trupit gjykues për çdo çështje, listë në të cilën pasqyrohet edhe çështja e kërkuarve.

26. Për sa më sipër, nisur nga fakti se rekursi në Gjykatën e Lartë është paraqitur nga vetë kërkuarët, të cilët kanë detyrimin të ndjekin fatin e çështjes së tyre dhe se ligji procedural i kohës parashikon, si rregull, shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit dhe njoftimin e palëve me shpallje, që, sipas kësaj mënyre, rezulton të jetë bërë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarve për mungesën e njoftimit të shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit në Gjykatën e Lartë është haptazi i pabazuar për sa i takon pretendimit për cenimin e *parimit të barazisë së armëve në procesin gjyqësor dhe të kontradiktoritetit* në drejtim të *së drejtës për shqyrtim efektiv e në mënyrë të pavarur të rekursit*.

27. Gjithashtu, kërkuarët kanë pretenduar se vendimi i kundërshtuar u ka cenuar *parimin e sigurisë juridike* në drejtim të *pritsmërive të ligjshme*. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se argumentet e kërkuarve për këtë pretendim lidhen me procesin gjyqësor të kundërshtuar, i cili sipas tyre ka cenuar *parimin e sigurisë juridike* në drejtim të *pritsmërive të ligjshme* për shkak të mosmbajtjes parasysh nga gjykatat të natyrës *quasi gjyqësore* të vendimeve të KKKP-së, Tiranë dhe moszbatimit të udhëzimeve të Gjykatës së Lartë për verifikimin e ligjshmërisë së AMTP-ve dhe të akteve të Komisionit të Tokës të Këshillit të Rrethit, Tiranë, çmon ta shqyrtojë atë në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Në këtë kontekst, duke mbajtur në konsideratë argumentet e lartpërmendura të kërkuarve, ajo vlerëson të analizojë në vijim bazueshmërinë e tyre në themel në drejtim të *aksesit substancial të lidhur me të drejtën e pronës*.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me të drejtën e pronës

28. Kërkuarët kanë pretenduar se, në kuptim të jurisprudencës kushtetuese dhe asaj të GJEDNJ-së, vendimi i KKKP-së, Tiranë, mbi bazën e të cilit ka fituar pasurinë trashëgimlënësi i tyre ka krijuar për ta të njëjtën pritshmëri që krijon një vendim gjyqësor i cili njeh pronësinë për sendin. Për rrjedhojë, për sa kohë pasuria në pronësi të kërkuarve është fituar me vendim të ish-KKKP-së, ai ka krijuar pritshmëri të ligjshme se ata se do të vihen në posedim të pronës ose do të dëmshpërblehen në lidhje me të.

29. Sipas subjekteve të interesuara, ata kanë fituar të parët titullin e pronësisë dhe është kjo palë që është cenuar në të drejtën që ligji t’i ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi të së drejtës së pronës. Sipas tyre, pritshmëritë e kërkuarve për kthimin dhe kompensimin e pronës nuk janë mohuar pasi gjykatat kanë vendosur kompensim për sipërfaqen e pronës së mbivendosur. Gjykata ka dhënë arsytet për vlerësimin e saj.

30. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon se liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila do t’i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Ajo nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe për të pasur një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Për sa i përket rolit të gjyqësorit të zakonshëm në garantimin e standardeve kushtetuese të sipërcituara, Gjykata ka theksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për proces

të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, aq më tepër i Gjykatës së Lartë. Roli i kësaj gjykate, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta (shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata e Lartë e ushtron këtë rol qoftë përmes standardizimit të praktikës gjyqësore, qoftë përmes dhënies së udhëzimeve zbatimi i të cilave është i detyrueshëm për gjykatën që rishqyrton çështjen. Gjykata në këto vendime pranon që Gjykata e Lartë ka një rol aktiv dhe “ligjor” kur u cakton detyra gjykatave të shkallëve të ulëta. Ky rol përfshin interpretimin e ligjit, kontrollin e bazueshmërisë së vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe një obligim arsyetimi për vendimet që ajo merr, veçanërisht kur ato lidhen me çështje me natyrë kushtetuese.

32. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, në rastin konkret Gjykata do të vlerësojë nëse kërkuesit kanë marrë një zgjidhje përfundimtare nga gjykatat për të drejtën e pronës së njohur me vendim të ish-KKKP-së, Tiranë, si dhe nëse Gjykata e Lartë ka verifikuar zbatimin nga gjykatat më të ulëta të detyrave të lëna prej saj me vendime të mëparshme për sa i takon ligjshmërisë së akteve të Komisioneve të Tokave të cilat paraqesin kontradikta në përmbajtjen e tyre.

33. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se me vendimin nr. 220/1995, të ish-KKKP-së Tiranë, kërkuesve u është kthyer 9.000 m² truall, i cili është regjistruar prej tyre në ish-ZRPP-në, Tiranë. Ky vendim është bërë objekt kundërshtimi në gjykatë. Pas rishqyrtimit dy herë të çështjes nga gjykata e apelit, Gjykata e Lartë me vendimin nr. 966, datë 21.10.1999, ka vendosur prishjen e vendimeve të gjykatave të faktit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë, duke lënë si detyra: i. vlerësimin e ligjshmërisë ose paligjshmërisë së AMTP-ve; dhe ii. thirrjen në gjykim, si persona të interesuar, të komisioneve përkatëse të ndarjes së tokës, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes sipas ligjit. Në rigjykim, me vendimin nr. 3124, datë 12.7.2002, gjykata e shkallës së parë ka vendosur pranimin e padisë, duke anuluar pjesërisht vendimin nr. 220/1995, të KKKP-së, Tiranë, si dhe urdhërimin e fshirjes së regjistrimit të pronës në emër të kërkuesve dhe regjistrimin e saj në emër të trashëgimtarëve të shtetasit Nj. Sh., vendim ky i lënë në fuqi nga gjykata e apelit. Mbi rekursin e kërkuesve, me vendimin nr. 1118, datë 1.6.2004, Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, me arsyetimin se: i. gjykatat më të ulëta nuk kanë vlerësuar ligjshmërinë e aktit të marrjes së tokës në pronësi dhe të vendimit që e ka anuluar atë, që paraqisnin kontradikta në përmbajtjen e tyre, si dhe të vendimit të ish-KKKP-së, Tiranë; ii. gjykatat më të ulëta nuk kanë zbatuar detyrat e lëna prej saj me vendimin nr. 966, datë 21.10.1999, të detyrueshme për gjykatën që rigjykon çështjen, bazuar në nenin 486 të KPC-së; iii. vendimi i gjykatës së apelit ka mungesë të analizës së provave dhe të bazës ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes. Në rigjykim, Gjykata e Apelit Tiranë, në zbatim të detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 32, datë 22.1.2007, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 3124, datë 12.7.2002, të gjykatës së shkallës së parë, rrëzimin e padisë dhe pranimin e kundërpadisë të paraqitur nga të paditurit (kërkuesit), duke detyruar paditësit që të lirojnë e dorëzojnë të paditurve kundërpaditës sipërfaqen prej 5.000 m². Ajo gjykatë, në zbatim të detyrave të lëna nga gjykata e Lartë, pasi ka gjykuar mbi ligjshmërinë e AMTP-ve në emër të shtetasit Nj. Sh., ka vlerësuar se ato janë të parregullta dhe se prona është kthyer në truall ndërtimi me vendime të Këshillit të Rregullimit të Territorit të datave 24.5.1994, 26.12.1994 dhe 12.4.1995, pra përpara se të hynte në fuqi ligji nr. 8053, datë 21.12.1995, “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, i cili përjashtonte dhënien në pronësi të tokës bujqësore dhe i kualifikonte të pavlefshme AMTP-të në këto raste, si dhe regjistrimet e tyre. Ky vendim është prishur sërish me vendim të Gjykatës së Lartë, e cila e ka dërguar çështjen për rigjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, me arsyetimin se, vendimi i gjykatës së apelit ka mungesë të analizës së provave dhe të bazës ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes.

34. Pas rigjykimit të çështjes, gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 3124, datë 12.7.2002, të gjykatës së shkallës së parë, që ka anuluar pjesërisht vendimin e ish-KKKP-së, duke u njohur kërkuësve të drejtën e kompensimit për sipërfaqen prej 5.000 m², në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji. Gjukata e apelit ka vlerësuar se, në kushtet kur është vërtetuar se sipas ligjit nr. 7501/1991 paditësit janë pronarë të ligjshëm të një parcele toke që sipas aktit të ekspertimit teknik kishte zërin kadastral “arë”, ish-KKKP-ja, Tiranë nuk duhet të kishte vendosur kthimin e saj si të lirë, por të kompensonte trashëgimtarët e ish-pronarit në një nga format e parashikuara me ligj. Po kështu, pavlefshmëria e akteve administrative nuk mund të konstatohej kryesisht pa kërkim dhe, referuar provave në gjykim, AMTP-ja e palës paditëse është e vlefshme e me fuqi ligjore, ndaj bazuar në nenin 296 të Kodit Civil, kërkuësit nuk mund të ngrinin padinë e rivendikimit ndaj pronarit posedues të kësaj pasurie. Ndërsa për sa i përket kundërpadisë, kërkitimi i së cilës kishte për objekt vetëm lirimin e dorëzimin e pronës nga ana e palës paditëse, vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë ishte e drejtë, pasi kërkuësit nuk kishin kundërshtuar titullin e pronësisë së palës paditëse në mënyrën dhe formën e duhur ligjore, por vetëm në kuadër të prapësimeve.

35. Gjukata e Lartë, me vendimin nr. 00-2024-698, datë 17.1.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi ishte bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikoheshin në nenin 472 të KPC-së, me arsyetimin se: i. gjykata e apelit ka respektuar normat procedurale, ii. palëve në procesin gjyqësor u është dhënë mundësia të realizojnë të drejtën e mbrojtjes, të paraqesin prova, të njihen me provat e palës kundërshtare e të debatojnë për to, si dhe të shprehin qëndrimin e tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjes; iii. janë respektuar dhe zbatuar drejt dispozitat e ligjit material, pasi në zbatim të detyrave të dhëna nga Gjukata e Lartë, gjykata e apelit, duke mbajtur në konsideratë kufijtë e shqyrtimit gjyqësor të saj dhe në aplikim të drejtë të nenit 36 të KPC-së, ka vepruar drejt duke mos mbajtur në konsideratë vendimin e marrë nga Komisioni i Tokës të Këshillit të Rrethit Tiranë për pavlefshmëri të AMTP-së të paditësit, për sa kohë që ky organ ka vepruar në kundërshtim me kompetencat e tij; iv. gjykata e apelit ka hetuar dhe ka arritur në përfundimin se sipërfaqja e disponuar me AMTP-në në favor të paditësit në momentin e dhënies në përdorim ose në pronësi, ka qenë tokë e llojit “arë”, gjë që e bënte atë objekt të disponimit në favor të subjekteve përfituese në zbatim të ligjit nr. 7501/1991; v. me të drejtë gjykata e apelit nuk ka marrë në konsideratë pretendimet e ngritura nga kërkuësit për pavlefshmërinë e AMTP-së lidhur me faktin se pala paditëse, punëtor i Ndërmarrjes Bujqësore, ishte me banim në qytet, me argumentimin se sipas vendimit unifikues nr. 5/2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjukatës së Lartë, pavlefshmëria e aktit administrativ nuk mund të konstatohet kryesisht nga gjykata ose mbi bazën e një prapësimi të palëve sikurse ndodh në rastet e pavlefshmërisë së veprimeve juridike. Sipas Gjukatës së Lartë, ky dallim bëhet për shkak se aktet administrative janë shprehje e vullnetit të organeve të sipërpërmendura në funksion të ushtrimit të kompetencave të tyre në bazë të ligjit dhe sjellin pasoja juridike si akte të organeve të pushtetit, pra i përkasin fushës të së drejtës publike. Në përfundim, Gjukata e Lartë ka vlerësuar se vendimi i dhënë nga Gjukata e Apelit Tiranë nuk vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Civil ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjukatës së Lartë dhe se shkaqet e parashtruara në rekurs, kanë ngritur kryesisht çështje të vlerësimit të provave dhe të fakteve, të cilat dalin jashtë juridiksionit rishikues dhe ligjor të saj.

36. Në analizë të sa më sipër, Gjukata konstaton se Gjukata e Lartë me vendimin nr. 966, datë 21.10.1999, ka dhënë orientime të detyrueshme për gjykatat e faktit lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së AMTP-ve dhe të akteve të Komisionit të Tokës së Këshillit të Rrethit Tiranë, për shkak të kontradiktave në përmbajtjen e tyre. Këto orientime janë përsëritur edhe në vendimin e Gjukatës së Lartë nr. 1118, datë 1.6.2004. Në rigjykimin e fundit, gjykata e apelit, edhe pse ka njohur të drejtën e pronësisë së kërkuësve, ka vlerësuar se: i. në kushtet kur paditësit janë pronarë të ligjshëm të pronës, sipas ligjit nr. 7501/1991, KKKP-ja Tiranë nuk duhet të vendoste kthimin e saj si të lirë, por duhet të vendoste kompensimin e trashëgimtarëve të ish-pronarit në një nga format e parashikuara me ligj, dhe se; ii. kërkuësit nuk mund të ngrinin një padi të thjeshtë rivendikimi pa

kërkuar më parë pavlefshmërinë e aktit administrativ (AMTP-së). Në analizë të vendimit të gjykatës së apelit, Gjykata vëren se ajo gjykatë nuk rezulton të jetë shprehur për problematikat e ngritura nga kërkuesit dhe të evidentuara nga Gjykata e Lartë në vendimin e vitit 1999, për ligjshmërinë e AMTP-ve dhe akteve të Komisionit të Tokës së Këshillit të Rrethit Tiranë, që kanë qenë edhe themeli i mosmarrëveshjes objekt kundërshtimi. Ndërkohë, Gjykata e Lartë, duke u ndodhur përpara situatës ligjore ku gjykatat e faktit (dhe vetë Kolegjet e Gjykatës së Lartë) kanë dhënë vendime të kundërta, si dhe nuk janë shprehur, edhe pse kishin detyrimin ligjor, për zbatimin e detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë lidhur me ligjshmërinë e akteve të marrjes së tokës në përdorim dhe në pronësi, si dhe të akteve të KT-së së Këshillit të Rrethit Tiranë, nuk rezulton t'u ketë dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të ngritura nga kërkuesit (pala e paditur/kundërpaditëse).

37. Duke mbajtur në konsideratë për sa më sipër, Gjykata vlerëson se, në kuadër të së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe në zbatim të parimit të subsidiaritetit, Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, duhej t'u jepte përgjigje përfundimtare, në aspektin substancial, pretendimeve të kërkuesve për mosmarrëveshjen objekt gjykimi. Për rrjedhojë, mungesa e një qëndrimi të Gjykatës së Lartë për problematikat në thelb të mosmarrëveshjes, u ka cenuar atyre të drejtën për akses substancial në atë gjykatë për pretendimet për cenimin e së drejtës së pronësisë.

38. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesve janë të bazuara, sipas arsytimit të mësipërm, ndaj kërkesa duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-698, datë 17.1.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.
Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 18.9.2025.

Shpallur më 30.12.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Genti Ibrahim, Marjana Semini

Anëtarë kundër: Marsida Xhaferllari

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që u përket kërkueseve Drita Pulleja dhe të tjerë, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-698, datë 17.1.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën, jam kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës, pasi vlerësoj se pretendimet janë të pabazuara, ndaj kërkesa duhej rrëzuar. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të Ligjit Organik të Gjykatës, që

parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtroj në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tim kundër.

2. Çështja konkrete ka në themelin e saj mosmarrëveshjen civile midis palëve për një truall prej 5000 m², të ndodhur në fshatin Mëzez, komuna Kashar, Tiranë. KKKP-ja, Tiranë, me vendimin nr. 220/1995, ka njohur pronësinë dhe ua ka kthyer kërkuësve sipas ligjit për kthimin e pronave, ndonëse në vitin 1993 ky truall i ishte dhënë fillimisht në përdorim dhe më pas në pronësi subjekteve të interesuara, trashëgimtarëve të shtetasit Nj. Sh., sipas ligjit për tokën. Subjektet e interesuara, të cilat e kishin në përdorim truallin, kanë ngritur padi, me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 220/1995 të KKKP-së, Tiranë për pjesën që u kthente kërkuësve truallin prej 5000 m², ndërsa kërkuësit, brenda të njëjtit proces, kanë ngritur kundërpadi, me objekt kthimin e truallit. Procesi gjyqësor ka filluar më 6.6.1996 dhe çështja është gjykuar tre herë në shkallë të parë (në vitet 1996, 2000 dhe 2002), gjashtë herë në shkallë të dytë (në vitet 1997, 1998, 2000, 2003, 2007 dhe 2015) dhe pesë herë në Gjykatën e Lartë (në vitet 1997, 1999, 2004, 2014 dhe 2024). Në përfundim të procesit, gjykatat e zakonshme kanë vendosur anulimin e pjesshëm të vendimit nr. 220/1995, të KKKP-së, Tiranë, për pjesën që u kthente kërkuësve truallin prej 5000 m² (vendimi i vitit 2002 i gjykatës së shkallës së parë), duke u njohur atyre (kërkuësve) të drejtën e kompensimit në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji (vendimi i gjykatës së apelit i vitit 2015). Gjykata e Lartë, me vendimin e datës 17.1.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuësve.

3. Në këto rrethana, kërkuësit kanë paraqitur ankim kushtetues individual, me pretendimet se vendimi i Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit u ka cenuar atyre të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e parimeve të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, si dhe të sigurisë juridike.

4. Shumica ka vlerësuar se pretendimi për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit është haptazi i pabazuar (*shih paragrafët 21–26 të vendimit*), ndërsa pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike e ka analizuar në këndvështrim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me të drejtën e pronës (*shih paragrafin 27 të vendimit*). Lidhur me këtë të fundit, shumica ka arritur në përfundimin se Gjykata e Lartë, me vendime të mëparshme, ka caktuar detyra të detyrueshme për gjykatat e faktit lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së AMTP-ve dhe të akteve të Komisionit të Tokës së Këshillit të Rrethit Tiranë, për shkak të kontradiktave në përmbajtjen e tyre. Sipas shumicës, gjykata e apelit nuk rezulton të jetë shprehur për këtë detyrë që ka qenë edhe themeli i mosmarrëveshjes objekt kundërshtimi. Gjykata e Lartë, duke u ndodhur përpara situatës ligjore, ku kolegjet e saj kishin dhënë vendime të kundërta, si dhe gjykatat e faktit nuk janë shprehur për zbatimin e detyrës të lënë nga Gjykata e Lartë në vitin 1999 për ligjshmërinë e akteve të marrjes së tokës në përdorim dhe në pronësi, nuk rezulton t’u ketë dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të ngritura nga kërkuësit. Për këtë arsye, sipas shumicës, mungesa e një qëndrimi të Gjykatës së Lartë për problematikën në thelb të mosmarrëveshjes, u ka cenuar kërkuësve të drejtën për akses substancial në atë gjykatë për pretendimet për cenimin e së drejtës së pronësisë (*shih paragrafët 36–37 të vendimit*).

5. Nuk pajtohem me këtë qëndrim të shumicës për tri arsye themelore. Së pari, kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata, në vlerësimin tim, janë tejkaluar nga shumica. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se sipas nenit 48 të Ligjit Organik të Gjykatës kufijtë e shqyrtimit të çështjes janë brenda objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të, ndërkohë që objekti dhe shkaqet e kërkesës, me të cilat ngrihet çështja e kushtetutshmërisë, përbëjnë thelbin (*thema decidendum*) e gjykimit kushtetues (*shih vendimet nr. 22, datë 23.4.2025; nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 20, datë 4.4.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Mbi bazën e këtij standardi, duhet evidentuar se “mungesa e qëndrimit të Gjykatës së Lartë ndaj mospërmbushjes së detyrave të lëna më parë prej saj në rigjykimin e çështjes nga gjykatat e faktit” nuk rezulton të jetë ngritur nga kërkuësit si shkak në aktin e ankimit kushtetues individual. Për rrjedhojë, jam e mendimit se shumica ka tejkaluar kufijtë e shqyrtimit të çështjes, duke hetuar ajo vetë rrethana dhe fakte që nuk janë parashtruar nga kërkuësit, pra duke marrë një rol aktiv të palejuar.

6. *Së dyti* nuk rezulton që kërkuessit në aktin e rekursit të kenë ngritur pretendimin që gjykata e apelit në rigjykimin e çështjes nuk ka zbatuar udhëzimet e Gjykatës së Lartë të vitit 1999, përkundrazi kanë parashtuar se udhëzimi i Gjykatës së Lartë në vendimin e vitit 2014 nuk ishte i drejtë. Duke mos e ngritur këtë shkak në rekurs, madje duke pasur një vlerësim të kundërt me atë që shprehet shumica, jam e mendimit se arsyetimi i shumicës nuk i përgjigjet as fakteve të çështjes dhe as ligjit të zbatueshëm. Në këtë pikë, evidentoj se një prej parimeve themelore të gjyimit civil është ai i disponibilitetit, i cili detyron gjykatën e zakonshme të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet (*neni 6 i KPC-së*) dhe Gjykatën e Lartë ta shqyrtojë rekursin brenda kufijve të tij (*neni 473/a i KPC-së*). Për rrjedhojë, është e pakuptueshme sesi Gjykata e Lartë duhet të mbante qëndrim të shprehur për një shkak që nuk ishte ngritur në rekurs.

7. *Së treti*, jam e mendimit se në substancë nuk qëndron konkluzioni i shumicës, sipas të cilit gjykatat e faktit në rigjykimin e çështjes, në kundërshtim me nenin 486 të KPC-së, nuk kanë zbatuar udhëzimet dhe konkluzionet e Gjykatës së Lartë. Për këtë konkluzion, shumica i referohet vendimit të vitit 1999 të Gjykatës së Lartë, me të cilin ajo ka prishur vendimet e gjykatave të faktit dhe ka urdhëruar rigjykimin e çështjes në shkallë të parë, duke lënë si detyrë verifikimin e të gjitha aspekteve të vendimit të komisionit të tokës për të konkluduar për ligjshmërinë ose kundërligjshmërinë e tij. Për këtë qëllim, sipas Gjykatës së Lartë, në rigjykim duhet të thirreshin të gjithë personat që kishin interes në çështje, konkretisht të gjitha komisionet e ndarjes së tokës dhe t'i jepej përgjigje kundërpadisë që mund të ngrihej në rigjykim.

8. Në vitin 2004 Gjykata e Lartë ka prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe ka urdhëruar rigjykimin e çështjes, me arsyetimin se gjykatat e faktit nuk kishin zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë në vitin 1999, pasi nuk kishin vlerësuar ligjshmërinë e akteve të komisioneve të tokës, me të cilat ishin anuluar aktet e marrjes së tokës në pronësi dhe përdorim nga subjektet e interesuara. Pas dhënies së këtij vendimi, Gjykata e Apelit Tiranë në vitin 2007 ka shqyrtuar në themel mosmarrëveshjen dhe ka vendosur, ndër të tjera, detyrimin e subjekteve të interesuara t'u dorëzojnë truallin kërkuessve. Gjykata e Lartë është vënë sërish në lëvizje, përmes rekursit të subjekteve të interesuara dhe në vitin 2014 ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe rigjykimin e çështjes në shkallë të dytë. Ajo ka arsyetuar se gjykata e apelit duhet ta hetonte plotësisht çështjen dhe të mbante në konsideratë nenin 36 të KPC-së, sipas të cilit organet administrative nuk mund të pranojnë për shqyrtim mosmarrëveshjen që është duke u shqyrtuar nga gjykata, ndaj, sipas saj, vendimet e komisionit të tokës për anulimin e akteve të ndarjes së tokës nuk duhet t'i nënshtroheshin shqyrtimit gjyqësor, si akte të nxjerra pas fillimit të procesit gjyqësor. Në vijim, Gjykata e Apelit Tiranë në vitin 2015 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me të cilin trualli u mbetej subjekteve të interesuara, por duke plotësuar vendimin me të drejtën e kërkuessve për t'u kompensuar për pronën, sipas mënyrave të parashikuara nga ligji.

9. Gjykata e Lartë në vitin 2024, e vënë në lëvizje nga kërkuessit, vendosi mospranimin e rekursit të tyre, duke arsyetuar, ndër të tjera, se gjykata e apelit me të drejtë nuk ka marrë në konsideratë pretendimet që kërkuessit kishin për titullin e pronësisë të subjekteve të interesuara. Sipas Gjykatës së Lartë, bazuar në vendimin unifikues nr. 5/2012, pavlefshmëria e aktit administrativ nuk mund të konstatohet kryesisht nga gjykata vetëm bazuar në prapësimin e palës.

10. Duke iu referuar këtij konteksti faktesh, rezulton se detyra e lënë nga Gjykata e Lartë në vitin 1999 për verifikimin e ligjshmërisë së titullit të pronësisë mbi truallin i referohej një ngjarjeje të ardhshme – kundërpadisë që mund të ngrihej nga kërkuessit në gjykim. Për sa i takon kësaj të fundit, kërkuessit kanë zgjedhur të ngrenë kundërpadinë e rivendikimit, duke kërkuar kthimin e truallit, që sipas tyre mbahej pa të drejtë nga subjektet e interesuara. Kjo do të thotë se kërkuessit nuk kanë ngritur padi për të kundërshtuar aktet administrative të lëshuara nga komisionet e tokës, por janë mjaftuar me prapësime në seancë gjyqësore për kundërligjshmërinë e tyre. Në këto rrethana, siç me të drejtë ka vënë në dukje Gjykata e Lartë në vitin 2024, ligjshmëria e titullit të pronësisë, që ishte akt administrativ, nuk mund të verifikohet me nismën e vet gjykatës, pasi një

verifikim i tillë do të binte ndesh me vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, ndaj qëndrimin se në thelb nuk rezulton që gjykata e apelit në vitin 2015 të mos ketë respektuar detyrat e Gjykatës së Lartë dhe as që kjo e fundit të mos ketë mbajtur qëndrim në këtë drejtim.

11. Për sa më lart, jam e mendimit se në rastin e mosmarrëveshjeve midis palëve private për të drejtën e pronës, ekziston gjithnjë mundësia që njëra prej palëve të humbasë në përfundim të gjykimit të drejtën e pronës, ndaj rezultati i gjykimit nuk mund të përbëjë *apriori* rrethanë vendimtare për të vlerësuar nga pikëpamja kushtetuese cenimin e së drejtës së pronës. Në këtë drejtim, duhet theksuar se, siç është pohuar në mënyrë konstante në jurisprudencën kushtetuese, vlerësimi i fakteve dhe i rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues (*shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Ndaj, vlerësimi kushtetues i Gjykatës nuk mund të zëvendësojë rolin dhe funksionin e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke e shndërruar atë në një shkallë të katërt gjykimi.

12. Në përfundim, çmoj se pretendimet e kërkuessve janë të pabazuara, për pasojë Gjykata duhet të vendoste rrëzimin e kërkesës.

Anëtare: Marsida Xhaferllari